

Bilanci i energjisë elektrike

Viti 2020


Tiranë, më 3 Mars 2021: Gjatë vitit 2020, energjia elektrike në dispozicion u ul me 0,3 %.

Prodhimi neto vendas i energjisë elektrike arriti vlerën 5.315 GWh nga 5.208 GWh energji të prodhuar në vitin 2019, duke shënuar një rritje të prodhimit me 2,1 %.

Ky prodhim u realizua nga hidrocentralet publike në masën 58,2 %, nga hidrocentralet private dhe koncensionare në masën 41,2 % dhe nga të tjerë prodhues (energji e rinovueshme) në masën 0,6 % të prodhimit neto vendas të energjisë elektrike.

Importi bruto i energjisë elektrike (energji në marrje), arriti vlerën 3.239 GWh nga 3.177 GWh që ishte një vit më parë, duke shënuar kështu një rritje me 2,0 %. Eksporti bruto i energjisë elektrike (energji në dhënie) arriti vlerën 963 GWh nga 770 GWh duke shënuar një rritje me 25,0 % (tab.1).

Fig. 1 Energji në dispozicion, prodhimi neto vendas, importi dhe eksporti bruto



Tab. 1 Bilanci i energjisë elektrike, vjetorë

Treguesit		MWh	
		2019	2020
A	Energji në dispozicion (A=1+2-3)	7,613,965	7,590,415
1	Prodhimi neto vendas (1=1.1+1.2+1.3)	5,207,929	5,314,811
1.1	Termocentrale	0	0
1.2	Hidrocentrale (1.2=a+b)	5,185,733	5,282,546
a	Publike (a=a.1-a.2)	2,981,136	3,091,977
a.1	Prodhim bruto i hidrocentraleve publike	3,009,839	3,121,234
a.2	Humbje dhe konsum vetjak	28,704	29,257
b	Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë	2,204,597	2,190,569
1.3	Të tjerë prodhues (energji të rinovueshme të tjera)	22,196	32,265
2	Importi bruto (energji në marrje)	3,176,515	3,238,631
3	Eksporti bruto (energji në dhënie)	770,480	963,027
B	Konsumi i energjisë elektrike (B=1+2)	7,613,965	7,590,415
1	Humbjet në rrjet (1.1+1.2)	1,653,466	1,631,717
1.1	Humbjet dhe konsumi vetjak në transmetim	168,621	172,198
1.2	Humbjet në shpërndarje (1.2=a+b) ¹	1,484,845	1,459,519
a	Humbjet teknike në shpërndarje	954,299	932,634
b	Humbjet jo teknike në shpërndarje ²	530,545	526,885
2	Përdorimi nga konsumatorët (2=2.1+2.2)	5,960,499	5,958,698
2.1	Familjarë	2,750,172	2,963,786
2.2	Jo Familjarë	3,210,328	2,994,912


¹ Detajimi i humbjeve teknike dhe jo teknike janë vlerësime të kryera nga operatorët që operojnë në fushën e energjisë elektrike.

² Humbjet jo teknike përbajnë edhe diferencat statistikore që rrjedhin nga mosdeklarimet e prodhimit dhe ndryshime nga koha e matjes së prodhimit e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit.

Hidrocentralet publike, në vitin 2020, prodhuan 3.092 GWh nga 2.981 GWh të prodhuar në vitin 2019, duke shënuar kështu një rritje të prodhimit me 3,7 %. **Hidrocentralet private dhe koncensionare**, prodhuan 2.191 GWh nga 2.205 GWh të prodhuar një vit më parë, duke shënuar një rënie të prodhimit të energjisë elektrike me 0,6 %.

Shkëmbimi i energjisë elektrike (diferenca mes eksportit dhe importit bruto të energjisë), në vitin 2020, ka pësuar një rritje me 5,4 % krahasuar me vitin 2019 (fig.2).


Fig. 2 Shkëmbimi i energjisë elektrike



Humbjet në rrjet kanë arritur vlerën 1.632 GWh nga 1.653 GWh duke shënuar kështu një rënie me 1,3 %. **Humbjet në transmetim** janë rritur me 2,1 % dhe pesha që zënë në totalin e humbjeve në rrjet është 10,6 %.

Humbjet në shpërndarje zënë një peshë më të madhe, rreth 89,4 % të humbjeve në rrjet dhe kanë rënë me 1,7 %, krahasuar me vitin 2019 (fig.3).


Fig. 3 Konsumi i energjisë elektrike, humbjet në rrjet dhe përdorimi nga konsumatorët



Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët, në vitin 2020, arriti vlerën 5.959 GWh nga 5.960 GWh që ishte në vitin 2019.


Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët familjarë u rrit me 7,8 %, duke arritur vlerën 2.964 GWh nga 2.750 GWh që ishte në vitin 2019, ndërsa **përdorimi nga konsumatorët jo familjarë** u ul me 6,7 % duke arritur vlerën 2.995 GWh nga 3.210 GWh që ishte një vit më parë (fig.4).

Fig. 4 Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët



Në fig.5 paraqitet **struktura në përqindje e prodhimit neto vendas sipas tremujorëve** për periudhën 2016-2020. Në vitin 2020 kemi një rritje të prodhimit neto në tremujorin e parë dhe të tretë dhe një rënie të prodhimit neto në tremujorin e dytë dhe të katërt, krahasuar me vitin 2019.

Fig. 5 Struktura në përqindje e prodhimit neto vendas sipas tremujorëve, 2016-2020 (%)



Tremujori IV 2020

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020, **energjia elektrike në dispozicion** u rrit me 9,7 %.

Prodhimi neto vendas i energjisë elektrike arriti vlerën 1.301 GWh nga 1.461 GWh energji të prodhuar në tremujorin e katërt të vitit 2019, duke shënuar një rënie të prodhimit me 11,0 % (tab.2).

Tab. 2 Bilanci i energjisë elektrike, tremujori IV

MWh


Treguesit	Tr. IV 2019	Tr. IV 2020
A Energji në dispozicion (A=1+2-3)	1,843,437	2,022,127
1 Prodhimi neto vendas (1=1.1+1.2+1.3)	1,461,409	1,300,567
1.1 Termocentrale	0	0
1.2 Hidrocentrale (1.2=a+b)	1,457,037	1,294,624
a Publike (a=a.1-a.2)	869,036	799,686
a.1 Prodhim bruto i hidrocentraleve publike	877,224	807,360
a.2 Humbje dhe konsum vetjak	8,188	7,675
b Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë	588,000	494,938
1.3 Të tjerë prodhues (energji të rinovueshme të tjera)	4,372	5,943
2 Importi bruto (energji në marrje)	821,090	974,710
3 Eksporti bruto (energji në dhënie)	439,062	253,150
B Konsumi i energjisë elektrike (B=1+2)	1,843,437	2,022,127
1 Humbjet në rrjet (1.1+1.2)	421,088	423,286
1.1 Humbjet dhe konsumi vetjak në transmetim	46,370	44,690
1.2 Humbjet në shpërndarje (1.2=a+b) ¹	374,718	378,596
a Humbjet teknike në shpërndarje	235,445	243,145
b Humbjet jo teknike në shpërndarje ²	139,273	135,451
2 Përdorimi nga konsumatorët (2=2.1+2.2)	1,422,349	1,598,841
2.1 Familjarë	667,871	773,026
2.2 Jo Familjarë	754,477	825,815

¹ Detajimi i humbjeve teknike dhe jo teknike janë vlerësime të kryera nga operatorët që operojnë në fushën e energjisë elektrike.

² Humbjet jo teknike përmbajnë edhe diferencat statistikore që rrjedhin nga mosdeklarimet e prodhimit dhe ndryshime nga koha e matjes së prodhimit e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit.

Rënia e prodhimit të energjisë elektrike, gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020, ka ndikuar në rritjen e importeve bruto të energjisë elektrike (energji në marrje) me 18,7 % dhe rënieën e eksporteve bruto të energjisë elektrike (energji në dhënie) me 42,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (fig.6).


Fig. 6 Energji në dispozicion, prodhimi neto vendas, importi dhe eksporti bruto



Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020, **humbjet në transmetim** kanë rënë me 3,6 %, ndërsa **humbjet në shpërndarje** janë rritur me 1,0 % (fig.7).

Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët u rrit me 12,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019. **Përdorimi nga konsumatorët familjarë** u rrit me 15,7 %, ndërsa **përdorimi nga konsumatorët jo familjarë** u rrit me 9,5 %.

Fig. 7 Konsumi i energjisë elektrike, humbjet në rrjet dhe përdorimi nga konsumatorët



Metodologjia

Bilanci i Energjisë Elektrike jep informacion statistikor mbi prodhimin neto vendas të energjisë elektrike, shkëmbimin e energjisë elektrike, humbjet në rrjet si edhe konsumin final në vendin tonë. Statistikat për energjinë elektrike publikohen për një periudhë tremujore nga të dhënat mujore të grumbulluara prej burimeve administrative si:

- KESH sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që prodhon, transformon dhe kryen shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike;
- OSHEE sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që kryen furnizimin, shitjen e energjisë elektrike si edhe operimin dhe menaxhimin e rrjetit të shpërndarjes;
- OST sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që operon në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike nga pikëpamja fizike dhe e shpërndarjes. OST sh.a garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:
 - furnizimin e pa ndërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes dhe konsumatorëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit;
 - transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit;
 - tranzitet dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit.

Përkufizimet e treguesve bazë

Energji në dispozicion i referohet sasisë së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhimi vendas i energjisë elektrike plus sasisë së importuar (përfshirë këmbimet) minus sasisë së eksportuar (përfshirë këmbimet).

Prodhimi neto vendas llogaritet si shumë e sasisë bruto të energjisë elektrike të prodhuar nga të gjithë prodhuesit në vend si prodhimi i hidrocentraleve, termocentraleve dhe prodhuesit e tjerë duke zbritur konsumin dhe humbjet vetjake në prodhim.

Energji termo i referohet energjisë elektrike të prodhuar nga termocentralet.

Energji hidro i referohet sasisë së energjisë elektrike të gjeneruar nga uji në hidrocentralet.

Humbjet dhe konsumi vetjak i referohet energjisë elektrike të përdorur nga veprimtaritë ndihmëse të stacionit të energjisë të lidhura direkt me prodhimin si psh. ftohje e ujit, shërbimet e stacionit të energjisë, ngrohje, ndriçim, etj.

Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë u referohen prodhuesve private të energjisë elektrike të cilët në rastin e Shqipërisë përbëhen nga impiante ish-publike të privatizuara ose impiante të ndërtuara nga subjektet private vendase apo të huaja përmes kontratave koncesionare me Republikën e Shqipërisë. Këta prodhues lidhen direkt në sistemin e transmetimit dhe liqensohen nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) dhe mund të shesin kapacitete ose energji OST-së dhe OSHEE-së, për të mbuluar humbjet në sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes, si edhe tek klientë të tjerë.

Prodhues të tjerë i referohet prodhimit të energjisë elektrike nga burime të tjera të energjisë, duke përfshirë energjinë hidro dhe termo.

Shkëmbimi i energjisë elektrike i referohet diferencës midis eksportit dhe importit të energjisë elektrike. Kjo përfshin edhe tranzitet dhe shkëmbimet (dhënie – marrje energjie) e nevojshme të energjisë elektrike me vendet e rajonit.

Konsumi i energjisë elektrike i referohet përdorimit nga konsumatorë familjarë dhe jo familjarë dhe sasisë së humbjeve në rrjet të energjisë elektrike.

Humbjet në rrjet përbëjnë humbjet në transmetim duke përfshirë edhe konsumin vetjak në transmetim si edhe humbjet në shpërndarje. *Humbjet teknike* në shpërndarje janë të vlerësuara nga OSHEE sh.a. *Humbjet jo teknike* i referohen diferencës së humbjeve gjithsej në shpërndarje me humbjet teknike në shpërndarje si edhe të diferencave statistikore që rrjedhin nga ndryshimet në kohën e matjes së prodhimit, e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit.

Përdorimi nga konsumatorët është i barabartë me shumën e energjisë elektrike të konsumuar nga konsumatorë familjarë dhe jo familjarë.

Familjarët i referohet sasisë së konsumit të energjisë elektrike në familje.

Jo familjarët i referohet sasisë së konsumit të energjisë elektrike nga sektorët e industrisë, transportit, agrikulturës, shërbimeve publike, etj. duke përfshirë konsumin nga familjarët.